

1. Të përgjithshme

Shoqëria tregtare "PREVISA" sh.p.k. është rregjistruar si person juridik me vendim të Gjykatës së Rrethit Tiranë Nr. 8475 datë 09.12.1993.

Shoqëria ka si aktivitet kryesor të saj: mport, eksport, prodhim i qirinjve, tregti me shumice e pakice i mallrave te ndryshme, qirinj, etj. Prodhim te produkteve industriale.

Kapitali i nënshkruar i shoqërisë është 60,000,000 lekë dhe përbëhet nga një ortak i vetëm: z. Visar Rexhepi. Me vendim të ortakut të vetëm të shoqërisë datë 23.01.2018 dhe kontratës së dhurimit të kuotave, datë 01.02.2018, është ndruar pronësia nga zj.Perije Rexhepi në favor të z.Visar Rexhepi, i cili bëhet ortak i vetëm i 100% të kuotës kapitalit.

Administrator i shoqërisë është z. Visar Rexhepi. Me vendim të ortakut të vetëm të shoqërisë, datë 08.02.2018, është larguar zj. Perije Rexhepi nga detyra e administratorit të shoqërisë dhe është vendosur administrator i ri i shoqërisë z.Visar Rexhepi.

Zyrat qendrore të shoqërisë ndodhen në Rrugën Hamdi Pepa, Tregu Ushqimor, Tiranë.

Adresa dytësore:1) Rruga Hamdi Pepa, Tregu Ushqimor, Tiranë; 2) Rruga Ibrahim Rugova, Sky Tower, Kati 1, Molla Store, Tirane; 3) Kashar, Katund i ri, Tiranë.

2. Bazat e përgatitjes

(a) Deklarata për pajtueshmëri

Pasqyrat Financiare janë përgatitur në përputhje me Standartet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara.

(b) Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur duke u bazuar në koston historike.

(c) Monedha funksionale dhe raportuese

Pasqyrat Financiare janë pasqyruar në Lekë, e cila është monedha funksionale e shoqërisë.

(d) Vlerësime dhe gjykimeve

Paraqitja e Pasqyrave Financiare në përputhje me Standartet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara, kërkon që manaxhimi të bëjë vlerësime dhe gjykime që ndikojnë në aplikimin e politikave kontabël dhe vlerën e raportuar të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave e shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga këto vlerësime.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën kur ndodh rishikimi dhe në cdo periudhë të ardhme që preket.

3. Politikat kontabël të rendësishme

(a) Transaksionet ne monedha të huaja

Transaksionet në monedhat e huaja janë perkthyer me kursin e kembimit te datës së transaksionit. Aktivet monetare në monedha te huaja janë perkthyer në Lek me kursin ne ditën e mbylljes së bilancit. Diferencat e konvertimit si pasojë e përkthimit të monedhave te huaja në Leke janë përfshirë në fitim humbje. Aktivet dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj jane raportuar me kursin historik të monedhës së huaj në datën e transaksionit. Aktivet dhe detyrimet jo-monetare në monedhe te huaj te vlerësuara me vlerën e drejtë janë përkthyer në Lek me kursin e monedhës së huaj në datën e bilancit.



Kurset e kembimit janë:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
1 EUR	123.42	132.95
1 USD	107.82	111.10

(b) Instrumentat financiarë

Shoqëria zotëron vetëm instrumenta financiare që përfshijnë llogari klientesh, mjete monetare, dhe llogari të tjera për tu paguar apo për tu arkëtuar me karakter tregëtar. Llogaritë e arkëtueshme dhe depozitat, njihen fillimisht në datën e krijimit të tyre. Të gjithë instrumentet e tjerë financiarë (përfshi dhe ata me vlerë të drejtë nëpërmjet të ardhurave dhe shpenzimeve), njihen fillimisht në datën kur shoqëria behet pale kontraktuale e nje instrumenti.

Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre

Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre përfshijnë paratë në dorë, depozitat në banka, investime afatshkurtra me likuiditet të lartë dhe afat maturimi me pak se tre muaj te cilat nuk janë subjekt i riskut te ndryshimit të vlerës se drejtë dhe përdoren nga Shoqëria në manaxhimin e angazhimeve afatshkurtra. Ato vlerësohen me vlerën nominale.

Llogaritë e klientëve dhe llogari të tjera te arkëtueshme

Llogaritë e klientëve dhe llogari të tjera të arkëtueshme janë vlerësuar me koston e amortizuar minus ndonjë zhvlerësim të mundshëm.

Llogaritë e furnitoreve dhe të tjera llogari të pagueshme

Llogaritë e furnitoreve dhe te tjera llogari të pagueshme janë vlerësuar me koston e amortizuar minus ndonjë zhvlerësim të mundshëm.

Të tjera

Instrumenta të tjere financiare janë vlerësuar me koston e amortizuar minus ndonjë zhvlerësim të mundshëm.

(c) Inventaret

Inventaret maten fillimisht me kosto. Pas njohjes fillestare te tyre shoqëria vlereson inventarin me vlerën me te ulet mes koston dhe çmimit të vlerësuar të shitjes pakësuar me koston për t'u përfunduar dhe shitur.

Inventaret i nenshtrohen testit te zhvleresimit ne daten e mbylljes se bilancit. Shuma e zhvleresimit njihet ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve atehere kur ka faktore te ojektive qe tregojne qe inventaret jane zhvleresuar.

Metoda e vleresimit eshte kosto mesatare.

(d) Aktivët Afatgjatë Materiale

(i) Njohja dhe matja

Aktivët Afatgjatë Materiale (makineritë e pajisjet) vlerësuar me kosto minus amortizimin e akumuluar sipas SKK 5 “Aktivët AA Materiale dhe AA Jomateriale”.



(ii) Kostot vijuese

Kosto e zëvendësimit të një pjese përbërëse të një prej aktiveve materiale afatgjata, njihet në vlerën e mbartur të aktivit, nëse është e mundur që Shoqëria do të ketë përfitime ekonomike të ardhshme nga ky veprim dhe kostoja e tij mund të matet me besueshmëri. Vlera e mbartur e pjesës së zëvendësuar çregjistrohet. Kostot e shërbimeve të përditëshme të aktiveve material afatgjata njihen në shpenzimet e periudhës kur ndodhin.

(iii) Zhvlerësimi

Zhvlerësimi (Amortizimi) i AA Materiale llogaritet sipas normave fiskale, të cilat në formën e perqindjeve paraqiten si me poshte:

	Norma e amortizimit
Makineri e paisje	20%
Mjete transporti	20%
Paisje zyre	20%
Paisje informatike	25%

Fitimet dhe humbjet që rrjedhin nga demtimi ose dalja jashtë përdorimit të një asemi, përcaktohen nga diferenca ndërmjet vlerës së përfituar të realizuar dhe vlerës së mbetur kontabel të asemi dhe kjo vlerë njihet si e ardhur apo shpenzim në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

(e) Zhvlerësimi i aktiveve**(i) Aktivitetet financiare**

Aktivitetet financiare vlerësohen në çdo datë të raportimit për të përcaktuar nëse ka ndonjë evidencë objektive për zhvlerësim. Një aktiv financiar zhvlerësohet nëse ka evidencë objektive që tregojnë se ka ndodhur një ngjarje humbjeje pas njohjes fillestare të aktivitetit që ndikon negativisht flukset e ardhshme monetare të vlerësuar për këtë aktivitet dhe nëse këto flukse mund të maten me besueshmëri.

Humbja nga zhvlerësimi i një aktiviteti financiar të matur me kosto të amortizuara llogaritet si diferenca mes vlerës së mbartur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme monetare të skontuara me interesin efektiv. Humbjet njihen si në llogaritë e fitim/humbjeve ashtu dhe në llogaritë e zbritjeve të arkëtueshmeve.

Aktivitetet financiare të rëndësishme testohen individualisht për zhvlerësim. Pjesa tjetër e aktiveve grupohen sipas karakteristikave të riskut të kredisë dhe vlerësohen në grup. Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në llogaritë e fitim/humbjes.

Kur një ngjarje e mëpasshme ul shumën e njohur të humbjes nga zhvlerësimi, ulja e humbjes nga zhvlerësimi rimerret në llogaritë e fitim/humbjes.

(ii) Aktivitetet jo-financiare

Vlera e mbartur e aktiveve jo-financiare me përjashtim të taksave të shtyra, rishikohet në çdo periudhë raportuese për të përcaktuar nëse ka ndonjë indikator për zhvlerësim. Nëse ekziston ndonjë indikacion i tillë, atëherë bëhet vlerësimi i shumës së rikuperueshme të aktivitetit. Në këtë mënyrë një humbje nga zhvlerësimi regjistrohet nëse vlera e mbartur në kontabilitet e këtij asemi e tejkalon vlerën e rikuperueshme. Këto humbje nga zhvlerësimi pasqyrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Vlera e rikuperueshme e një aktiviteti përcaktohet si me e madhja midis vlerës së tij të përdorimit dhe vlerës së drejte minus koston e shitjes. Në përcaktimin e vlerës së përdorimit, parashikimi i



flukseve monetare skontohej për të aritur tek vlera aktuale duke përdorur normat e skontimit përpara taksave që reflekton vlerësimin aktual të tregut për vlerën në kohë të parase dhe të rreziqeve specifike të këtij aktivi.

Humbjet nga çvlerësimi të regjistruara në periudhat e mëparshme rivelesohen në çdo periudhë raportuese për të parë ndonjë indikator nëse këto humbje janë zvogeluar ose nuk ekzistojnë më. Një humbje nga çvlerësimi rishikohet nëse ka ndonjë ndryshim të parashikimeve të bëra në përcaktimin e vlerës së rikuperueshme. Një humbje nga rivlerësimi rishikohet deri në atë masë sa vlera e mbartur e aktivitetit nuk tejkalon vlerën e mbartur neto nga amortizimi, nëse kjo humbje nuk do të ishte regjistruar fare.

(f) Përfitimet e punonjësve

Shoqëria, gjatë aktivitetit të saj, kryen pagesa në emër të saj dhe të punonjësve të saj, për të kontribuar në skemat e pensionit në përputhje me legjislacionin në fuqi. Kostoja e përballuar në emër të shoqërisë regjistrohet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve ashtu siç ndodhin.

(g) Provizionet për rreziqe

Provizionet për rreziqe pranohen kur shoqëria ka një detyrim aktual (ligjor apo të pranuar tërthorazi), si rezultat i ndodhive në të kaluarën dhe ka gjasa që përmbushja e këtyre detyrimeve kërkon sakrificimin e burimeve në pronësi të shoqërisë të cilat do të sillnin përfitime ekonomike në të ardhmen, dhe shoqëria ka mundësi të përcaktojë besueshëm vlerën e këtyre rreziqeve. Provizionet përcaktohen duke bërë skontimin e shumave të parashikuara për tu paguar në të ardhmen me normat e skontimit para tatimit që reflektojnë vlerësimin aktual të tregut për vlerën në kohë të parase dhe të rreziqeve specifike të këtij detyrimi.

(h) Kostot e huamarrjes

Shoqëria njeh të gjitha kostot e huamarrjes si shpenzim në periudhën në të cilën ato janë kryer.

(i) Njohja e të ardhurave

Të ardhurat përfshijnë vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar apo të arkëtueshme nga shitja e të mirave dhe kryerja e shërbimeve në rrjedhën normale të aktiviteteve të kompanisë. Të ardhurat nuk përfshijnë tatimin mbi vlerën e shtuar, kthimet, rabatet dhe zbritjet.

(j) Njohja e shpenzimeve

Shpenzimet janë njohur mbi bazën e të drejtave të konstatuara. Të ardhurat dhe shpenzimet janë njohur sipas metodës së konstatimit të të drejtave dhe detyrimeve. Shpenzimet janë njohur në vitin ushtrimor si dhe të ardhurat që lidhen me to (procesi i përputhjes së të ardhurave me shpenzimet).

(k) Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhurat nga interesat për llogaritë bankare, dhe përfitimet nga diferencat e këmbimit. Interesat njihen ashtu siç përlllogariten duke përdorur metodën e interesit efektiv. Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet për interesa dhe humbjet nga diferencat e këmbimit. Fitimet dhe humbjet nga kurset e këmbimit raportohen në baza neto.

(l) Tatimi mbi fitimin

Tatimi mbi fitimin paraqitet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përjashtuar rastet kur lidhet me zërat e kapitalit e për rrjedhim paraqitet në kapital.



PREVISA SHPK

Shenimet shpjeguese për pasqyrat financiare të mbyllura më 31 dhjetor 2018

(Shumat janë shprehur në Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

Tatimi është tatimi i parashikuar për tu paguar, i përlogaritur mbi fitimin e tatueshëm për vitin, duke përdorur normat tatimore në fuqi (15%) në datën e bilancit si dhe cdo korrjzim të tatimit të pagueshëm të periudhave të mëparshme.

SHPJEGIME PER ZERAT KRYESORE TE PASQYRAVE FINANCIARE**4 Mjete Monetare**

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Banka	1,607,742	147,103
Arka	84,483	407,380
Totali	1,692,225	554,483

5 Aktive te tjera financiare afatshkurta


	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
<i>Në tituj pronësie të njësive ekonomike brenda grupit</i>	-	-
<i>Aksionet e veta</i>	-	-
<i>Te tjera Financiare</i>	-	-
Totali	0	0

6 Të drejta të arkëtueshme

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
<i>Nga aktiviteti i shfrytëzimit</i>	6,584,638	8,296,224
<i>Nga njësitë ekonomike brenda grupit</i>	-	-
<i>Nga njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse</i>	-	-
<i>Të tjera</i>	12,969,149	33,112,279
<i>Kapital i nënshkruar i papaguar</i>	-	-
Totali	19,553,787	41,408,503

7 Inventarët

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
<i>Lëndë e parë dhe materiale të konsumueshme</i>	12,085,516	7,960,469
<i>Prodhime në proces dhe gjysëmprodukte</i>	-	-
<i>Produkte të gatshme</i>	12,807,580	13,866,722
<i>Mallra</i>	64,609,578	28,108,774
<i>Aktive Biologjike (Gjë e gjallë në rritje e majmëri)</i>		
<i>AAGJM të mbajtura për shitje</i>		
<i>Parapagime për inventar</i>		
Totali	89,502,674	49,935,966



Aktive Afatgjata Materiale

8

	Toka	Ndertesat	Makinieri pajise	Mjete transporti	Pajisje Zyre	Pajisje Informatike	Pajisje të Tjera	AAGJ ne Proces	TOTALI
Me 31.12.2017									
Vlerë Bruto	-	-	17,453,593	11,541,500	1,628,837	1,149,367	1,697,512	35,582,038	69,052,846
Amortizim i akumuluar	-	-	7,706,266	5,770,970	533,204	817,136	133,417	-	14,960,994
Vlerë kontabël neto	-	-	9,747,327	5,770,530	1,095,632	332,230	1,564,096	35,582,038	54,091,853
									0
Shtesa-Blerjet gjatë vitit 2018			10,192,943	2,300,000	42,433	47,825		19,639,521	32,222,722
Pakësime gjatë vitit 2018				2,600,000	422,638	77,946	1,587,512		4,688,096
Shpenzimet e amortizimit 2018			2,297,038	1,394,338	152,089	65,391	19,433		3,928,289
Pakësime amortizimi 2018				1,951,161	47,701	10,384	120,583		2,129,828
									-
Me 31.12.2018									-
Vlerë Bruto	-	-	27,646,536	11,241,500	1,248,632	1,119,246	110,000	55,221,559	96,587,473
Amortizim i akumuluar	-	-	10,003,304	5,214,148	637,592	872,144	32,267	-	16,759,454
Vlerë kontabël neto	-	-	17,643,232	6,027,352	611,040	247,102	77,733	55,221,559	79,828,018



PREVISA SHPK

Shenimet shpjeguese për pasqyrat financiare të mbyllura më 31 dhjetor 2018

(Shumat janë shprehur në Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

8 Aktive materiale

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
<i>Toka dhe ndërtesa</i>	-	-
<i>Impiante dhe makineri</i>	17,643,232	9,747,327
<i>Të tjera Instalime dhe pajisje</i>	6,963,228	8,762,488
<i>Parapagime për aktive materiale dhe në proces</i>	55,221,559	35,582,038
Totali	<u>79,828,018</u>	<u>54,091,853</u>

9 Detyrime afatshkurtra

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
<i>Titujt e huamarrjes</i>		
<i>Detyrime ndaj institucioneve të kredisë</i>	43,152,419	26,580,546
<i>Arkëtime në avancë për porosi</i>	2,263,119	598,109
<i>Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit</i>	33,909,063	26,522,798
<i>Dëftesa të pagueshme</i>		
<i>Të pagueshme ndaj njësive ekonomike brenda grupit</i>		
<i>Të pagueshme ndaj njësive ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse</i>		
<i>Të pagueshme ndaj punonjësve dhe sigurimeve shoqërore/shëndetsore</i>	327,914	227,807
<i>Të pagueshme për detyrimet tatimore</i>	346,390	1,659,027
<i>Të tjera të pagueshme</i>	11,700,000	-
Totali	<u>91,698,905</u>	<u>55,588,288</u>

Detyrime ndaj institucioneve të kredisë për shumën 43,152,419 Leke është shuma e përdorur e overdrafteve. Shoqëria ka marrë dy overdrafte, sipas kontratës: -nr.7089 date 01.11.2018 me "Intesa Sanpaolo Bank Albania" sh.a. me shumë kufi për 300.000 Euro, me afat 12 muaj dhe norme interesi Euribor 1 vjeçar plus marzh prej 3%;
-nr.3903 date 07.12.2018 me "Raiffeisen Bank" sh.a. me shumë kufi për 50.000 Euro, me afat 12 muaj dhe norme interesi Euribor 1 vjeçar plus marzh prej 3.5%;

10 Detyrime afatgjata

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
<i>Titujt e huamarrjes</i>		
<i>Detyrime ndaj institucioneve të kredisë</i>		-
<i>Arkëtimet në avancë për porosi</i>		
<i>Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit</i>		
<i>Të pagueshme ndaj njësive ekonomike brenda grupit</i>		
<i>Të pagueshme ndaj njësive ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse</i>		
<i>Të tjera të pagueshme</i>		
Totali	<u>0</u>	<u>0</u>



PREVISA SHPK

Shenimet shpjeguese për pasqyrat financiare të mbyllura më 31 dhjetor 2018

*(Shumat janë shprehur në Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)***11 Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit**

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Shitje e punimeve, sherbimeve	-	-
Shitje produktesh gatshme dhe mallra	58,470,237	53,229,126
Shitje mallrash	138,561,639	190,306,936
Shitje materiale te para	2,125,504	26,740
Totali	<u>199,157,380</u>	<u>243,562,802</u>

12 Te ardhura te tjera te shfrytezimit

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Te ardhura qirate		
Transport per te trete	-	-
Te ardhura te tjera	-	-
Totali	<u>0</u>	<u>0</u>

13 Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Blerje /Shpenzime materjale	38,031,669	37,981,845
Blerje /Shpenzime materjale te tjera	2,182,064	-
Blerje /Shpenzime mallra, materiale	95,771,250	150,394,244
Totali	<u>135,984,983</u>	<u>188,376,089</u>

14 Të tjera shpenzime

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Blerje /Shpenzime te tjera	4,043,389	2,220,033
Totali	<u>4,043,389</u>	<u>2,220,033</u>

15 Shpenzime të personelit

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
<i>Paga dhe shpërblime</i>	12,308,794	9,743,945
<i>Shpenzime të sigurimeve shoqërore/shëndetsore</i>	2,132,790	1,648,760
Totali	<u>14,441,584</u>	<u>11,392,705</u>

16 Shpenzime konsumi dhe amortizimi

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Amortizimi i aktiveve afatgjata materiale	3,928,289	4,349,070
	-	-
Totali	<u>3,928,289</u>	<u>4,349,070</u>



17 Shpenzime të tjera shfrytëzimi

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Qira	4,092,524	3,624,154
Mirembajtje dhe riparime	2,277,772	423,561
Shpenzime energji, uje	2,532,339	2,283,580
Shpenzime publicitet, reklame	329,200	203,200
Sigurime	170,392	355,446
Personel jashte njesise	198,000	77,824
Udhetime dieta	107,680	486,000
Shpenzime postare	607,569	551,474
Shpenz transporti	9,683,726	8,181,802
Te tjera sherbime	2,296,280	1,752,962
Sherbime bankare	1,004,257	749,532
Taksa, tarifa vendore	690,634	986,589
Akciza	2,248,592	-
Taksa, tarifa doganore	3,702,984	6,526,202
Taksa per automjetet	64,963	126,500
Shpenzime te shtyra	-	6,000,000
Gjoha demshperblime	-	72,657
Shpenzime tjera	-	124,810
Totali	30,006,911	32,526,293

18 Të ardhura të tjera

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
<i>Të ardhura nga njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse</i>		
<i>Të ardhura nga investimet dhe huatë e tjera pjesë e aktiveve afatgjata</i>	(625,379)	-
<i>Interesa të arkëtueshëm dhe të ardhura të tjera të ngjashme</i>	2,311,625	736,910
Totali	1,686,246	736,910

19 Shpenzime financiare

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
<i>Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngjashme</i>	1,264,244	1,232,809
<i>Shpenzime të tjera financiare</i>	144,164	
Totali	1,408,408	1,232,809

20 Shpenzimi i tatimit mbi fitimin

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Fitimi/Humbja para tatimit	9,970,920	7,693,112
<i>Shpenzime te pa zbritshme</i>	-	72,657
Gjoha demshperblime	-	72,657
Totali	0	72,657
Fitimi tatimor	9,970,920	7,765,769



PREVISA SHPK

Shenimet shpjeguese për pasqyrat financiare të mbyllura më 31 dhjetor 2018

(Shumat janë shprehur në Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

Fitimi tatueshem neto	9,970,920	7,765,769
Tatimi mbi fitimin (15%)	1,495,638	1,164,865
Fitimi/Humbja e vitit	8,475,282	6,528,247

21 Angazhime dhe pasiguri

-Çështje gjyqësore

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje është se nuk do të ketë efekte negative në pozicionin financiar të shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj. Me 31 Dhjetor 2018 shoqëria nuk ka asnjë çështje gjyqësore të hapur kundrejt saj apo nga ajo, që mund të kërkojë rregullime të këtyre pasqyrave financiare.

-Detyrimet tatimore

Shoqëria nuk është kontrolluar nga organet tatimore për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2018. Si rrjedhojë detyrimet tatimore nuk mund të konsiderohen përfundimtare. Detyrime të mundshme që mund të rezultojnë nga një kontroll i organeve tatimore nuk mund të maten në mënyrë të besueshme.

22 Ngjarje mbas mbylljes së bilancit

Pas datës së mbylljes së bilancit nuk ka ndonjë ngjarje të rëndësishme e cila kërkon rregullime të pasqyrave financiare, apo dhënien e shpjegimeve plotësuese për to.

ADMINISTRATORI

VISAR REXHEPI

